

RAPORT VJETOR PËR GJENDJEN ME
**GJUHËN E
URREJTJES**

NË NIVEL LOKAL NË QYTETET, TETOVË,
MANASTIR DHE SH TIP PËR VITIN 2021



Наслов на оригиналот:

Годишен извештај за состојбата со говорот на омраза на локално ниво во градовите: Тетово, Битола и Штип за 2021 година

Botues: Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, përfaqësuar nga kryetarja Prof. Dr. Neda Zdraveva

Redaktimi: Uranija Pirovska

Autorë: Slavica Anastasovska, Oliver Mitov

Përkthim nga gjuha maqedone në gjuhën shqipe: Paulin Jano

Dizajni grafik dhe shtypja: Masiva Dooel Shkup

Vendi i botimit: Shkup

Viti i botimit: 2021

Tirazhi i botimit: 30 ekzemplarë

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

316.625:316.647.5(497.7-21)"2021"(047)

ANASTASOVSKA, Slavica

Raport vjetor për gjendjen me gjuhën e urrejtjes në nivel lokal në qzitetet, Tetovë, Manastir dhe Shtip për vitin 2021 / [autorë Slavica Anastasovska, Oliver Mitov ; përkthim nga gjuha maqedone në gjuhën shqipe Paulin Jano]. - Shkup : Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut, 2021. - 34 стр. : илустр. ; 22 см


Превод на делото: Годишен извештај за состојбата со говорот на омраза на локално ниво во градовите: Тетово, Битола и Штип за 2021 година

ISBN 978-608-4977-04-9

1. Mitov, Oliver [автор]

а) Говор на омраза -- Локална заедница -- Македонија -- 2021 -- Извештаи

COBISS.MK-ID 55878917



PËRMBAJTJA

Parathënie	1
Për raportin	2
PJESA E PARË	
Gjendja me gjuhën e urrejtjes për vitin 2021 për qytetet Tetovë, Manastir dhe Shtip	3
Raste të shënuara të gjuhës së urrejtjes në qytetin Tetovë	4
Raste të shënuara të gjuhës së urrejtjes në qytetin Manastir	8
Raste të shënuara të gjuhës së urrejtjes në qytetin Shtip	12
Konkluzione	16
Rekomandime	17
PJESA E DYTË	
Keqtrajtimi në internet	18
Gjetja nga hulumtimi	19
Konkluzione	27
Rekomandime	28
PJESA E TRETË	
Gjuha e urrejtjes ndërmjet grupeve të tifozëve	29
Gjetje nga zbatimi i grupit të fokusit	30
Konkluzione	33
Rekomandime	34

Raporti vjetor për gjendjen e gjuhës së urrejtjes në nivel lokal në qytetet Tetovë, Manastir dhe Shtip për vitin 2021 paraqet një analizë përfundimtare për gjendjen e gjuhës së urrejtjes të përgatitur në kuadër të projektit Aksion i përbashkët kundër gjuhës së urrejtjes.¹ Projekti ka të bëjë me monitorimin e gjuhës së urrejtjes në tri bashkësi lokale në Maqedoni, përkatësisht Tetovë, Manastir dhe Shtip. Ky raport bazohet në një monitorim tetë mujor të gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale, monitorim dhe analizë të aktiviteteve të grupeve të tifozëve, lëvizjeve dhe shoqatave rinore, eventeve të karakterit publik nëpër komuna, shkrimit të grafiteve, eventeve kulturore etj. Në raport është dhënë fokus i veçantë në keqtrajtimin e internetit nëpërmjet prezantimit të gjetjeve që i detektojnë gjendjet në nivel lokal për këtë fenomen në të tre qytetet, duke analizuar konkluzionet dhe rekomandimet për njohjen sistematike, identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve që shkaktojnë dhunë, mostolerancë, padurim. Në raport gjithashtu theksohet një seksion i veçantë ku është dhënë rishikim i gjuhës së urrejtjes ndërmjet grupeve të tifozëve në nivel lokal në të tre qytetet, ku gjithashtu janë prezantuar gjetje, konkluzione dhe rekomandime.

Në kuadër të aktiviteteve të projektit, ekipi i projektit në bashkëpunim me bërthamat rinore lokale kanë lokalizuar hapësira publike me grafite me gjuhën e urrejtjes dhe të njëjtat i kanë mënjanuar në mënyrë që në ato vende janë shkruar mesazhe dashurie, tolerance dhe mirëkuptimi.

Në kuadër të Projektit është përgatitur dhe zbatuar një mini fushatë online për rritjen e ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit të publikut të gjerë me fokusin kryesor të të rinjve mbi problemin me gjuhën e urrejtjes dhe paragjykimeve.

¹ Projekti është mbështetur dhe i financuar nga ana e Fondacionit shoqëri e hapur Maqedoni në kuadër të Konceptit Partneritete në bashkësitë për avancimin e demokracisë lokale.

PËR RAPORTIN

Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut për të dytin vit rradhazi e zbaton monitorimin e gjuhës së urrejtjes në qytet Manastir, Shtip dhe Tetovë. Raporti vjetor për gjendjen e gjuhës së urrejtjes në nivel lokal në qytetet Manastir, Shtip dhe Tetovë për vitin 2021 është raporti i dytë rradhazi i këtij lloji², ku në një kontinuitet (vazhdimësi) prej dy vitesh në mënyrë komparative (krahasuese) e jep gjendjen e gjuhës së urrejtjes në të tre bashkësitë lokale. Raporti ka për qëllim që ti prezantojnë në mënyrë objektive dhe t'i dokumentojë rastet e gjuhës së urrejtjes të identifikuar dhe të shënuara nga ana e mbikëqyrësve lokalë³.

Raporti është i strukturuar në tre tërësi kryesore tematike. Pjesa e parë e raportit përmban një përshkrim të rasteve të gjuhës së urrejtjes në të tre komunitet lokale të identifikuar. Më tej analizohen rastet e shënuara dhe të dokumentuara të gjuhës së urrejtjes për çdo qytet në mënyrë të veçantë dhe në mënyrë krahasuese analizohen të dhënat nga viti paraprak. Janë analizuar konkluzione dhe janë dhënë rekomandime.

Pjesa e dytë e Raportit për herë të parë në Maqedoni e trajton temën e keqtrajtimit në internet tek të rinjtë e shkollave të mesme në të tre qytetet. Keqtrajtimi në internet është në thelb një formë keqtrajtimi dhe frikësimi duke përdorur mjete elektronike ose keqtrajtim nëpërmjet internetit. Keqtrajtimi në internet po bëhet më shfaqje më e zakonshme tek adoleshentët, sepse disponueshmëria e veglave digjitale dhe teknologjia përparon shumë⁴. Në kuadër të aktiviteteve të projektit, u krye një anketë në të tre qytetet përmes një pyetësi anonim online, të cilit iu përgjigjën të paktën 100 nxënës të shkollave të mesme nga secili qytet. Në këtë pjesë të Raportit analizohet shpeshtësia e keqtrajtimit në internet, format e frikësimit, pasojat për shëndetin psikofizik, etj. Krahas konkluzioneve nga ky hulumtim në raport janë dhënë rekomandime në drejtimin që të arrihet gjendja e cila nuk do të shkaktojë agresion të tillë në rrjetet sociale.

Pjesa e tretë e raportit i është përkushtuar detektimit të gjendjeve me gjuhën e urrejtjes tek anëtarët e grupeve të tifozëve sportivë në të tre qytetet. Në kuadër të aktiviteteve të projektit ishte planifikuar që të zbatohen tre grupe fokusi me grupe tifozësh nga qytetet Manastir, Shtip dhe Tetovë⁵. Me kuadër metodologjik të përgatitur paraprakisht për zbatimin e grupeve të fokusit ishin fituar të dhëna nga anëtarët e grupeve të tifozëve sportive. Si edhe në dy pjesët e para të raportit edhe në këtë pjesë të raportit janë analizuar konkluzione dhe janë dhënë rekomandime.

² <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2021/02/godishen-izveshta%D1%98-za-monitoring-na-govor-na-omraza-na-lokalno-nivo-2020.pdf>

³ Në çdo qytet ishte angazhuar nga një mbikëqyrës lokal

⁴ <https://en.wikipedia.org/wiki/Cyberbullying>

⁵ Grupet e fokusit me grupet e tifozëve nga qytetet Manastir dhe Shtip nuk janë mbajtur për shkak të refuzimit të grupeve të tifozëve për çfarëdo lloj bashkëpunimi dhe komunikimi me ekipin e projektit

PJESA E PARË

Gjendja me gjuhën e urrejtjes për vitin 2021 për qytetet Tetovë, Manastir dhe Shtip

Kjo pjesë e raportit i është përkushtuar gjendjes me gjuhën e urrejtjes në nivel lokal, më tej janë analizuar të gjitha rastet e dokumentuara të gjuhës së urrejtjes në qytetet Tetovë, Manastir dhe Shtip në vitin 2021 në periudhën nga muaji janar deri në muajin gusht të vitit 2021. Prania e gjuhës së urrejtjes në këto tre mjedise lokale edhe më tej e minon ndjenjën e sigurisë, me çka vazhdimisht është e nevojshme nevoja për gjetjen e qasjes efikase për zgjidhjen e gjuhës së urrejtjes si në nivel lokal ashtu edhe në nivel kombëtar. Gjatë dokumentimit dhe analizës së të gjitha rasteve të raportuara të gjuhës së urrejtjes në të tre qytetet ishte analizuar me vëmendje e drejta dhe rëndësia e lirisë së shprehjes, toleranca dhe respekti i barazisë dhe dinjitetit, në drejtim që të identifikohen të gjitha rastet e vërteta të gjuhës së urrejtjes në diskursi publik qoftë ajo të jenë raste të gjuhës së urrejtjes të shënuara online ose në evente publike, ndeshje sportive ose gjuha e urrejtjes e shprehur në formë të grafiteve dhe vizatimeve.

Llojet dominuese të gjuhës së urrejtjes në këto tre qytete edhe më tej mbeten gjuha e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike, gjuha e urrejtjes në bazë të përkatësisë politike dhe gjuha e urrejtjes ndaj pjestarëve të komunitetit LGBTI+. Mbajtja e “Paradës së krenarisë” në Shkup në muajin qershor edhe në këto tre mjedise lokale edhe pse jo direkt të lidhura me mbajtjen e këtij eventi shkaktoi gjuhën e urrejtjes në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Në sipërfaqet publike edhe më tej shkrihen me grafitë edhe vizatime me përmbajtje ofenduese që shkaktojnë padurim, mosrespektim dhe urrejtje.

Nga ana e ekipit të projektit në pajtueshmëri me Metodologjinë e përcaktuar paraprakisht ishin mbikëqyrur edhe raportuar evente lokale, sipërfaqet publike, hapësira online, publikime nga portale lokale, televizione etj., profile lokale nga rrjetet sociale⁶ dhe grupe që publikojnë përmbajtje të lidhura me kontekst lokal.

Raporti për gjendjen me gjuhën e urrejtjes në nivel lokal në qytetet Tetovë, Shtip dhe Manastir përveç asaj që jep statistika të rasteve të shënuara të gjuhës së urrejtjes për vitin 2021, jep një sublimat të diskursit të përgjithshëm publik të lidhur me ngjarjet ekonomike shoqërore dhe politike pikërisht në atë kontekst negativ në prizmin e urrejtjes që ekziston ndërmjet qytetarëve.

⁶ Facebook, Twitter, Instagram, You Tube etj.

RASTE TË SHËNUARA TË GJUHËS SË URREJTJES NË QYTETIN TETOVË


Në Tetovë në periudhën nga muaji janar 2021 deri në muajin gusht 2021 janë shënuar dhe dokumentuar gjithsej 52 raste të gjuhës së urrejtjes, përkundër 40 rasteve të gjuhës së urrejtjes të shënuara në vitin 2020 për të njëjtën periudhë. Tridhjetë nga gjithsej pesëdhjetë e dy janë raste të gjuhës së urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike, nga të cilat deri në 25 raste të gjuhës së urrejtjes të drejtuara drejt Maqedonasve, dhe 5 rastet e tjera të gjuhës së urrejtjes janë të drejtuara drejt Shqiptarëve. Në vitin 2021 janë shënuar gjithsej 13 raste të gjuhës së urrejtjes në bazë religjioze/ fetare që ekskluzivisht janë drejtuar ndaj jo myslimanëve. Indikative është padurimi fetar dhe urrejtja ndaj të gjithë atyre që nuk janë myslimanë. Në të gjitha këto raste të gjuhës së urrejtjes në bazë të përkatësisë fetare janë nënçmuar dhe ofenduar të krishterët dhe të tjerët që nuk janë myslimanë duke i quajtur me fjalë fyese dhe ofenduese. Në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor ishin shënuar dhe regjistruar gjithsej 9 raste, këto raste janë shënuar gjatë kohës së mbajtjes së “Paradës së krenarisë” në muajin qershor në Qytet. Këto raste të gjuhës së urrejtjes të drejtuara direkt ndaj përkatësve të komunitetit LGBTI+ janë të tretët sipas përfaqësimit në diskursin publik në Tetovë. Në vitin 2021 janë shënuar numër i konsiderueshëm më i vogël i vizatimeve në sipërfaqet publike në formë të grafiteve ose mesazheve ofenduese që përmbajnë gjuhën e urrejtjes. Domethënë përkrah 7 rasteve të shënuara të gjuhës së urrejtjes nëpërmjet vizatimit të vizatimeve dhe grafiteve në objekte dhe sipërfaqe publike në zonën e qytetit në vitin 2020, në vitin 2021 është shënuar vetëm një grafit. Grafiti i vetëm i shënuar përmban gjuhën e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike. Thuajse të gjitha rastet e gjuhës së urrejtjes janë shënuar në rrjetet sociale ose gjithsej 51 raste dhe ato paraqesin publikime apo komente nga konteksti lokal. Ndërsa vetëm një rast i vetëm është shënuar në sipërfaqe publike në formë të grafitit të vizatuar.

Krahasuar me vitin 2020 dhe në vitin 2021 në Tetovë dominuese edhe më tej mbetet gjuha e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike / nacionale, me shpeshtësi të konsiderueshme më të madhe të gjuhës së urrejtjes ndaj Maqedonasve, Shqetësues është padurimi, mospranimi dhe urrejtja ndërmjet tyre në bazë të përkatësisë religjioze dhe fetare ndaj personave jo myslimanë. Të gjitha 13 rastet që ishin të shënuara në hapësirën e internetit ka të bëjë me gjuhën e urrejtjes ndaj të krishterëve ose grupeve të tjera religjioze që nuk janë myslimanë. Facebook dhe Twitter janë rrjetet sociale më të përfaqësuara ku përhapet gjuha e urrejtjes. Të gjitha rastet e gjuhës së urrejtjes të drejtuara ndaj pjesëtarëve të komunitetit LGBTI+ në Tetovë ishin të regjistruara në muajin Qershor gjatë kohës së mbajtjes së “Paradës së Krenarisë” të dytë në Shkup. Ky lloj i gjuhës së urrejtjes në Tetovë është i pranishëm pavarësisht nga konteksti etnik. Në vitin 2021 nuk ishte shënuar asnjë rast i gjuhës së urrejtjes në bazë të përkatësisë politike, përkundër vitit 2020 ku në Tetovë ishin shënuar 3 raste.

Në vijim janë dhënë disa figura si shembuj të formave më të shpeshta të gjuhës së urrejtjes në qytetin e Tetovës.

Figura 1

Më datën 10.06.2021 në profilin – facebook të portalit të internetit **Tetova News** ishte publikuar lajm i lidhur me zjarrin që ndodhi në Jerusalem. Në komentet e këtij lajmi është mbajtur gjuha e urrejtjes në bazë të përkatësisë religjioze, ksenofobisë dhe antisemitizmit.



GJUHËNË E
URREJTJES

Figura 2

Më datën 24.6.2021 në faqen - facebook të portalit të internetit Tetovo Denes (Tetova Sot) ishte publikuar lajm i lidhur me mbajtjen e “Paradës së Krenarisë” për këtë vit. Ky publikim shkaktoi një sërë komentesh negative dhe gjuhë urrejtjeje në bazë të orientimit seksual.



DUHET TË VDESE DIKUSH QË TË SHPËTOJMË NGA KËTA

NUK E KAM TË QARTË A MUND TË MË SHPJEGOJË DIKUSH PËR ÇFARË JANË KRENARË PEDERAT QË JANË LEZBIKE PËR ÇFARË KRENOHEN

DO TU DHEMBË BYTHA DITËN E NESËRME NGA PUNA SHUMË E LODHSHME

PËRPARA PEDERASTË MATANË UJIT PËR LIRI




Figura 3

Gjatë muajit maj në hyrjen e qytetit të Tetovës në lidhësen kryesore të qarkullimit në një nga muret prej betoni është vënë re mbishkrim me përmbajtjen “Vdekje për Kaurët”. Ky mbishkrim paraqet gjuhë eksplicite të urrejtjes në bazë të etnisë, nacionalitetit dhe religjionit.



RASTE TË SHËNUARA TË GJUHËS SË URREJTJES NË QYTETIN MANASTIR

Për periudhën nga muaji janar 2021 deri në muajin gusht 2021 në Manastir janë shënuar 46 raste të gjuhës së urrejtjes përkundër 55 rasteve të gjuhës së urrejtjes të shënuara të njëjtën periudhë për monitorimin në vitin 2020⁷. Të gjitha rastet e gjuhës së urrejtjes janë shënuar në rrjetet sociale Facebook, Twitter dhe Tik Tok, ndërsa mungojnë raste me vizatimin e grafiteve dhe vizatimeve në sipërfaqet publike të qytetit. Numri më i madh i rasteve të shënuara të gjuhës së urrejtjes janë të drejtuara ndaj komunitetit LGBTI+ dhe ajo gjithsej 25 raste (përkundër 8 rasteve nga viti paraprak 2020), që paraqet më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të rasteve të gjuhës së urrejtjes në vitin 2021 ose 54%. Manastiri “ka një bollëk” me raste të ndryshme të gjuhës së urrejtjes. Është shënuar një rast i gjuhës së urrejtjes në bazë të prejardhjes sociale, është shënuar një rast i seksizmit, dy raste të ksenofobisë, më tej janë shënuar 7 raste të gjuhës së urrejtjes në bazë të përkatësisë politike të shprehur nëpërmjet urrejtjes së disidentëve politikë dhe një rast të gjuhës së urrejtjes në bazë të gjendjes shëndetësore të lidhur me pandeminë me Covid-19. Në vitin 2021 në Manastir janë shënuar 4 raste të gjuhës së urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike përkundër 36 rasteve të shënuara në vitin e kaluar 2020.

Konstatimi nga viti paraprak 2020⁸ se në Manastir Romët janë komuniteti i më i marginalizuar dhe se po e përballojë gjuhën më intensive të urrejtjes⁹ në komunikimin e përditshëm në rrjetet sociale, vërtetohet edhe në këtë raport, ku nga gjithsej 5 raste të regjistruara të gjuhës së urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike, tre janë gjuha e urrejtjes që janë të drejtuara në mënyrë direkte dhe eksplicite ndaj Romëve.

Është indikativë sjellja e publikut të Manastirit në lidhje me çështjen për mbrojtjen e të drejtave të Romëve që jetojnë në këtë qytet. Nëse viti paraprak 2020 raste me Romët e rrahur¹⁰ u mundua që të fshihet dhe përveç asaj Romët ishin gjykuar si të dëmshëm për shoqërinë, është i habitshëm numri i madh i qytetarëve që protestojnë kundër gjykimit të policit që i rrahu Romët shtatorin e kaluar të vitit 2020¹¹.

Komuniteti LGBTI+ gjatë të gjithë vitit, dhe veçanërisht në periudhën e mbajtjes së “Paradës së krenarisë” në nivel lokal në Manastir u përball me sulme të përditshme dhe përcmime, duke shprehur gjuhë intensive të urrejtjes në hapësirën publike të internetit. Komentet në rrjetet sociale Facebook dhe Twitter thuajse gjithmonë thërrisnin për dhunë fizike, përcmime,

⁷ <https://mhc.org.mk/reports/godishen-izveshta%d1%98-od-monitoring-na-govor-na-omraza-na-lokalno-nivo-vo-gradovite-tetovo-bitola-i-shtip-2020/>

⁸ idem

⁹ Burimi platforma e internetit www.govornaomraza.mk

¹⁰ [tps://www.slobodenpecat.mk/pretepanite-romi-od-bitolskata-policzija-svedochea-vo-zhivo-ne-maltretiraa-kako-stoka-ne-tepaa-i-drzhea-vo-stanicza-do-5-sabajle-video/](https://www.slobodenpecat.mk/pretepanite-romi-od-bitolskata-policzija-svedochea-vo-zhivo-ne-maltretiraa-kako-stoka-ne-tepaa-i-drzhea-vo-stanicza-do-5-sabajle-video/)


¹¹ https://www.facebook.com/watch/live/?ref=watch_permalink&v=320522839520086

degradime të dinjitetit njerëzor të këtyre njerëzve, duke treguar në për një fikje dhe mospranim të plotë.

Në vijim janë dhënë disa figura si shembuj për format më të shpeshta të gjuhës së urrejtjes në qytetin Manastir.

Figura 1

Më datën 09.08.2021 në grupin e facebook “Bitolski problemi” (Problemet e Manastirit) ishin shpërndarë fotografi nga fshati Dihovo, ku shihen plehrat dhe mbeturinat e hedhura. Komentet në lidhje me këtë publikim janë në drejtim të fajësimit të Romëve dhe popullatën rome si fajtorë, duke i prezantuar si të dëmshëm për shoqërinë, dhe në atë mënyrë duke përhapur gjuhën e urrejtjes.



PARA DISA DITËSH KISHTE DISA FAMILJE NGA BAIRO

KY ËSHËTË VIRUS DHE JO COVID, CAO PËRSHËNDETJE

VENDOSINI ÇAKMAKUN DHE DO TË PASTROHET


KUR NUK I LËSHOJNË DIKU THËRRASIN MEDIA, BASHKËSI ROME ETJ.. 10 VJET LENË LEDNFILL KUDO KU ARRIJNË DHE LIGJI ASNJËHERË NUK I PËRNDJEK.. DHE OFENDOHEM KUR I THËRRET EVGJITË..

Figura 2

Më datën 28.6.2021 me rastin e mbajtjes së paradës së krenarisë në Shkup, në Manastir u mbajt kundër-paradë e “Parada e vërtetë e krenarisë”. Ky lajm ishte publikuar në faqen - facebook të portalit të internetit “Тоçка”. Komentet e këtij publikim përmbajnë gjuhë homofobike dhe transfobike, si edhe përfaqësimin e ideve fashiste.

Tocka
3 d · 🌐

Вчера вечер во Битола се одржа „Вистинска парада на гордоста“, на која учесниците самоиницијативно се организирале преку социјал... See more



ТОЧКА.COM.MK
Контра парада во Битола под името „Вистинска парада на гордоста“: „Да се зачув...“

and 1.3k others 92 comments · 24 shares

👤 [Redacted] Vistinski grad-vistinska parada pederski grad-pederska parada 😊😊😊
3 d Like Reply 23 🍌

👤 [Redacted] БРАВО, ТОА СЕ ВИСТИНСКИТЕ ВРЕДНОСТИ ЗА ГОРДОСТ-ФАМИЛИЈА, ДЕЦА, ЉУБОВ
3 d Like Reply 3 🍌

👤 [Redacted] ovaа e fasizoidam. ovie ne gi priznavale sklonostite na одредени gragani koi neli gospod takvi gi daril, isto kako sto hitler ne gi racunase za luge na evreite ili deka se lige odvtorai treta kategorija za slovenskite narodi, romite ... priznavanjeto na vrodניתe sklonosti na одредени gragani ne e politika tuku civilizaciska vrednost... moe mislenje
3 d Like Reply 6 🍌

View 1 more reply...

👤 [Redacted] Вистинскиот народ ја промовира вистинската парада на Гордоста 🍌🍌
Вистинскиот народ ја промовира вистинската парада на Гордоста 🍌🍌

POPULLI I VËRTETË E PROMOVON PARADËN E KRENARISË. DHE PRESIDENTI I SHTETIT MBAN FLAMUR ME YLBER... ÇFARË MIZERJE... DHE KUSH E DI MBASE EDHE FËMIJËT PO I PËRGATIT QË TË JENË KRENARË MBASE DËSHIRON QË I BIRI TË SJELLË DHËNDËR NË SHTËPI.

and 1.3k others >

View 1 more reply...

👤 [Redacted] Вистинскиот народ ја промовира вистинската парада на Гордоста 🍌🍌. А претседателот на државата вее знамето на виножитото.... која беда... а кој знае мош па и децата си ги спрема да му бидат горди мош сака син му, да му донесе дома ЗЕТ
2 d Like Reply 3 🍌

ajttt mos uba

View 2 more replies...

👤 [Redacted] Respekt za bitolçani 🍌
2 d Like Reply 1 🍌

👤 [Redacted] Bravo Bitolçani 🍌

QYTETI I VËRTETË-PARADA E VËRTETË QYTET PDERAST – PARADË PDERASTËSH

KY ËSHTË FASHIZËM. KËTA NUK I NJOHIN PRIRJET E QYTETARËVE TË CAKTUAR QË ZOTI TË TILLË I KA KRIJUAR, NJËLLOJ SI HITLERI QË NUK I LLOGARISTE PËR NJERËZ HEBRENJTË OSE QË JANË NJERËZ TË KATEGORISË SË DYTË DHE TË TRETË PËR POPIJT SLLAVË, ROMËT ... NJOHJA E PRIRJEVE TË LINDURA TË QYTETARËVE TË CAKTUAR NUK ËSHTË POLITIKË POR VLERË CIVILIZIMI... MENDIMI IM.

Figura 3

Më datën e mbajtjes së paradës së krenarisë në Shkup më datën 26.6.2021 për shkak të dukshmërisë së zmadhuar të komunitetit LGBTI, në rrjetin social Instagram nga ana e një përdoruesi privat nga Manastiri ishte publikuar mesazh me përmbajtje shqetësuese dhe që nxiti diskriminim.



GJUHEN E URREJTJES

RASTE TË SHËNUARA TË GJUHËS SË URREJTJES NË QYTETIN SH TIP

Në vitin 2021 në Shtip janë shënuar një numër dy herë më i madh i rasteve të gjuhës së urrejtjes dhe ajo gjithsej 88 raste përkundër 36 rasteve të gjuhës së urrejtjes të shënuara në vitin 2020. Të gjitha rastet e gjuhës së urrejtjes janë shënuar në rrjetet sociale dhe paraqesin publikime ose komente për ngjarje të lidhura me kontekstin lokal apo nacional të ngjarjeve. Nuk janë shënuar grafite. Në periudhën e mbikëqyrjes së filluar nga muaji janar deri në muajin gusht të vitit 2021 nuk janë shënuar grafite ose vizatime në hapësira publike që transmetojnë mesazh të gjuhës së urrejtjes. Nga të gjitha rastet e shënuara të gjuhës së urrejtjes më e përfaqësuar është gjuha e urrejtjes e drejtuar ndaj komunitetit LGBTI+ dhe gjuha e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike të drejtuar ndaj Shqiptarëve, Romëve dhe Vllahëve. Në vend të tretë sipas përfaqësimit është gjuha e urrejtjes në bazë të përkatësisë politike.

Në Shtip janë shënuar gjithsej 67 raste të gjuhës së urrejtjes në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Gjuha e urrejtjes e drejtuar ndaj komunitetit LGBTI+ është më e përfaqësuar në qytetin Shtip me deri 76% nga numri i përgjithshëm i rasteve. Në vitin paraprak 2020 ishin shënuar vetëm 6 raste të gjuhës së urrejtjes në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Me siguri mund të ndodhë që mbajtja e “Paradës së Krenarisë” në muajin qershor paraqet shkak për shpeshtësinë e tillë të gjuhës së urrejtjes. Në muajin maj janë shënuar 13 raste, në muajin qershor 37 raste dhe në muajin gusht 15 raste të gjuhës së urrejtjes ndaj komunitetit LGBTI+.



Padurimi dhe mospranimi i dallimeve në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor e përforcoi gjuhën diskriminuese dhe gjuhën e urrejtjes ndaj komunitetit LGBTI+ që kulmoi në rrjetet sociale. Ishin të dukshme kërcënimet, thirrjet për linçim nga jeta, demoralizim, komente nga lloji dhe forma më përçmuese me përmbajtje jashtëzakonisht shqetësuese.

Gjuha e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike, gjithashtu si edhe në vitin paraprak 2020 është në mënyrë të konsiderueshme e pranishme me gjithsej 15 raste të dokumentuara për vitin 2021 përballë 23 rasteve të vitit paraprak. Numri i rasteve të gjuhës së urrejtjes në bazë të përkatësisë politike për vitin 2021 është 6 dhe është identike me vitin paraprak 2020.

Në vijim janë dhënë disa figura si shembuj për format më të shpeshta të gjuhës së urrejtjes në qytetin Shtip.

Figura 1

Në profilin facebook të televizionit në Shtip “TV-Star – Televizija Star” më datën 12.4.2021 ishte publikuar lajm për kryerjen e veprës penale në një lagje të qytetit Koçani. Në këtë lajm lidhen komente me retorikën negative ndaj Romëve. Ato përmbajnë gjuhën direkte të urrejtjes dhe thirrje për dhunë ndaj Romëve.



MPB TURP POLICIA ME EVGJITË DHE CIGANË NË TË GJITHË MK NUK MUND TË MERRET...

TAHIR. JU CIGANËT ME TË VËRTETË MBETËT TË BUDALLENJ DHE TË BUDALLENJ DO TË VDISNI. NUK U SOCIALIZUAT NË KOMUNITET DHE JETONI NË GETO. TAHIR A E DI SE ÇFARË PO FLET. NA OFENDON NE MAQEDONASI QË PUNOJMË DHE PËR NE EDHE PËR JU. JU JENI FIS I KEQ FIS JO PUNËTOR I PAKULTURUAR FIS I KEQ. THËRRET QË TË VIJË JO 20001 PO 2001 NUK JE I SHKOLLUAR. PRA JU NUK E MBROJTËT MAQEDONINË SEPSE JENI MUSLIMANË ISHIT ME SHQIPTARËT TERRORISTË. TË TË THEM TË DREJTËN, NËSE VJEN EDHE NJË HERË NJË GJË E TILLË DO TË DUHET TË KETË EDHE NJË HERË PASTRIM TË SHTETIT NGA TË GJITHË JU QË E URRENI POPULLIN MAQEDONAS.



Figura 2

Më datën 5.5.2021 në profilin – facebook „Dnevna doza vesti i makedonski humor“ (Doza ditore e lajmeve dhe humorit maqedonas) ka qenë i publikuar lajm për vendimin e marrë në Kroaci me të cilin lejohet që partnerët të së njëjtës gjini të mund të adoptojnë fëmijë. Në vijim të lajmit pason koment që paraqet gjuhën e urrejtjes ndaj pjestarëve të komunitetit LGBTI, me thirrjen për dhunë.



Дневна Доца Вести и Македонски Хумор
5d · 🌐

ИСТОРИСКА ОДЛУКА ВО ХРВАТСКА! Геј партнерите можат да усвојуваат деца
<http://ow.ly/GCGg30rGLOG>



VESNIK.COM

ИСТОРИСКА ОДЛУКА ВО ХРВАТСКА! Геј партнерите можат да усвојуваат деца
После одлуката на Управниот суд во Загреб и геј партнерите имаат право на усвојување ...

👍👎👤 154 184 Comments 3 Shares

👍 Like 🗨 Comment ➦ Share

👤 [Redacted] **Еден да не остане, од прв до последен трагата да ви загина**
Like · Reply · 5d 26




ASNJË TË MOS MBETET,
NGA I PARI DERI TEK I
FUNDIT JU HUMBËTË
GJURMA.


GJUHEN E
URREJTJES

Figura 3

Në profilin twitter “@Majevtika” më datën 12.2.2021 ishte shpërndarë lajm nga gazetari Petrit Saraçini që paraqet gjykim ndaj veprimit të deputetit të partisë “Levica” Dimitar Apasiev. Ky lajm nxiti dhe inicioi gjuhën e urrejtjes në bazë të përkatësisë politike dhe etnike.



1. PËRMBAJU TEMËS
2. SEVERXHANI NUK I REFEROHET POPULLIT MAQEDONAS POR NJË GRUPI TRADHËTARËSH!



DHE TANI ME SHQIPTARËT ME POLTRONËT.



KONKLUZIONE

1. Gjuha më e përfaqësuar e urrejtjes në nivel lokal në qytetet: Tetovë, Manastir dhe Shtip është gjuha e urrejtjes në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor .
2. Ndarja e shoqërisë në bazë etnike reflektohet edhe në nivel lokal, dhe prej këtu në qytetet: Tetovë, Manastir dhe Shtip është evidentuar gjuhë e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike.
3. Paragjykimet dhe stereotipat ndaj pjestarëve të komunitetit LGBTI janë të shprehura në mënyrë të qartë në të gjitha tre qytetet. Mbajtja e “Paradës së krenarisë” më datën 26 qershor në Shkup nën sloganin “Jashtë mureve” shkakton në mënyrë plotësuese gjuhë të fortë të urrejtjes ndaj komunitetit LGBTI+.
4. Përdorimi i rrjeteve sociale dhe internetit paraqesin hapësirën kryesore për shkëmbimin e informacioneve, por japin edhe liri të madhe të shprehjes. Në mungesë të rregullores precize kjo hapësirë digjitale në thelb është vendi kryesor ku përhapet gjuha e urrejtjes.
5. Mosekzistimi i mekanizmit gjithëpërfshirës nacional/lokal për ndjekjen e gjuhës së urrejtjes në hapësirën digjitale.
6. Mungesë e kornizës gjithëpërfshirëse dhe të qyrtë juridike për ndjekjen, regjistrimin dhe raportimin e gjuhës së urrejtjes në hapësirën publike nga ana e institucioneve.

REKOMANDIME

Në pajtueshmëri me gjetjet dhe konkluzionet që rrjedhin prej këtij Raporti, dhe me qëllim që të detektohet dhe të parandalohet intensiteti i zmadhuar i gjuhës së urrejtjes dhe në vend të saj të promovohet parimi i tolerancës dhe mos diskriminimit, propozohet këto rekomandime:

1. Themelimi i mekanizmit edukativ gjithëpërfshirës në arsimin fillor dhe atë të mesëm, të përfshirë në kuadër të arsimit qytetar me qëllim pranimin e dallimeve dhe tejkalimin e hershëm të paragjyqimeve.
2. Ndërgjegjësim për pasojat e rrezikshme nga gjuha e urrejtjes nëpërmjet zbatimit të fushatave publike nga ana e institucioneve dhe trupave kompetente, si edhe nxitjen e personave publike për reagime të shpejta kundër gjuhës së urrejtjes.
3. Promovim të përdorimit të mekanizmave për vetë-rregullimin nga ana e trupave publike dhe private.
4. Përmirësim të edukimit digjital dhe të medimeve në nivel të publikut të përgjithshëm, me qëllim që të lexohen dhe të transmetohen në mënyrë kritike informacione në lidhje me komunikimin etik dhe të sigurt.
5. Plotësim të Kodit Penal dhe shtimin e orientimit seksual dhe identitetit gjinor si një nga bazat për përndjekjen e autorëve që përhapin gjuhën e urrejtjes nëpërmjet sistemeve kompjuterike dhe shkaktojnë përçarje dhe padurim.
6. Krijim të kornizës juridike gjithëpërfshirëse dhe të qartë me qëllim sanksionimin efektiv dhe efikas të gjuhës së urrejtjes dhe veprave nga urrejtja.

PJESA E DYTË

Keqtrajtimi në internet (cyber bullying)

Në kuadër të projektit “Aksion i përbashkët kundër gjuhës së urrejtës në nivel lokal” si aktivitet i veçantë ishte kryer hulumtim me temën “keqtrajtimi në internet”. Hulumtimi ishte zbatuar në periudhën nga data 20.05.2021 deri më datën 10.06.2021 në shkollat e mesme “Sllavço Stojmënski” në Shtip, “Shtatë Marsi” në Tetovë dhe “Josip Broz-Tito” në Manastir. Ishin përfshirë gjithsej 317 persona të anketuar në moshën nga 15-18 vjeç, pas fitimit të pajtueshmërisë paraprake nga ana e Ministrisë së arsimit dhe shkencës dhe nga ana e drejtorëve të shkollave të mesme. Hulumtimi është zbatuar nga ana e agjencisë “Segment research” Shkup nëpërmjet pyetësorit online anonim. Pyetësor online ishte i strukturuar në mënyrë që të tregojë të dhëna të caktuara demografike tek personat e anketuar, të dhëna të lidhura me statusin dhe pozicionin e tyre social, orientimin seksual dhe identitetin gjinor, ekspozimin dhe shpeshësinë e keqtrajtimit në internet, format më të shpeshta të keqtrajtimit në internet, si edhe pasojat mbi shëndetin e nxënësve.

Definim i keqtrajtimit në internet

Më nivel internacional dhe në nivel evropian nuk ka definicion të vetëm për keqtrajtimin në internet, por ekzistojnë mundime për definimin e këtij fenomeni nga ana e organizatave internacionale edhe institucionet evropiane. Nga viti 2009, KB e theksoi rëndësinë e përballimit me sajber-urrejtjen, që gjithashtu përfshinte keqtrajtimin në internet. Konkretisht, në Rekomandimet e vitit 2009 për promovimin e internetit dhe shërbimeve të mediave online të përshtatshme për të mitur, keqtrajtimi në internet ishte i definuar si vazhdim i keqtrajtimit tradicional në hapësirën-syber.¹²

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut mungon definimi për keqtrajtimin në internet, si edhe mundime të dukshme nga ana e shtetit për identifikim, prevenim, parandalim, dhe mbrojtje të këtij fenomeni.

¹² [PACE - Recommendation 1882 \(2009\) - The promotion of Internet and online media services appropriate for minors \(coe.int\)](https://www.coe.int/t/e/treaties/Convention_on_the_Protection_of_Children_against_Sexual_Exploitation_and_Abuse/Convention_on_the_Protection_of_Children_against_Sexual_Exploitation_and_Abuse.pdf)

GJETJE NGA HULUMTIMI

Analizë demografike dhe numri i të anketuarve

Hulumtimi për përfaqësimin e keqtrajtimin në internet tek nxënësit e shkollës së mesme në qytetet: Shtip, Tetovë dhe Manastir është e zbatuar në mostrën reprezentative nga 317 personave të anketuar nga të cilët 196 femra dhe 121 meshkuj të anketuar, nga të gjitha katër vitet e shkollimit. Nga viti i parë i arsimit të mesëm kanë qenë të anketuar 85 nxënës, nga viti i dytë 101 nxënës, nga viti i tretë 87 nxënës dhe nga viti i katërt 44 nxënës. Nga gjithsej 317 të anketuar 196 ishin Maqedonas, Shqiptarë 100, 21 të anketuar ishin përkatës të komuniteteve të tjera që jetojnë në RMV. Nga numri i përgjithshëm i të anektuarëve, 191 u shprehën si të krishterë ortodoksë, 102 të anketuar u shprehën si myslimanë, 13 të anketuar u shprehën si ateistë, dhe 5 të anketuar nuk i kanë dhënë përgjigje kësaj pyetjeje.

Orientimi seksual dhe identiteti gjinor

Në lidhje me pyetjen e orientimit seksual 245 persona u shprehën si heteroseksualë, 4 si homoseksualë, 9 si biseksualë, 3 si aseksualë dhe 56 persona refuzuan që të japin përgjigje kësaj pyetjeje. Në lidhje me pyetjen e identitetit gjinor 256 persona u shprehën si ciseksualë, 2 persona si transgjitorë, si person jo-binar u shprehën 5, ndërsa 34 e të anketuarëve refuzuan të përgjigjen. Nga 34 – e personave që refuzuan t'i japin përgjigje kësaj pyetjeje 76% ose 26 persona jetojnë në Tetovë dhe me besim fetar janë myslimanë – temë tabu.¹³

Persona me aftësi të kufizuara

Nga gjithsej 317 persona të anketuar 23 persona të anketuar u shprehën si persona me aftësi të kufizuara.

Përdorim të rrjeteve sociale

Nga gjithsej 317 e të anketuarëve 310 përdorin rrjete sociale, ndërsa shtatë (7) e të anektuarëve nuk përdorin rrjete sociale.¹⁴ Kjo e dhënë është relevante nga aspekti i besueshmërisë dhe rëndësisë së të dhënave të fituara nga personat e anketuar sepse vetë hulumtimi ka të bëjë me keqtrajtim në internet, dhe njëkohësisht arsyetohet relevanca e të dhënave të fituara.


¹³ Temë tabu - <http://drmj.eu/show/%D1%82%D0%B0%D0%B1%D1%83/%D1%81%D1%80>

¹⁴ Të gjithë ata e kanë prejardhjen nga familje me shumë anëtarë, në të cilën ka vetëm një anëtar të punësuar në familje, të gjithë janë Shqiptarë nga Tetova dhe me përkatësi religjioze janë myslimanë.

Koha e kaluar në rrjetet sociale

Në lidhje me kohën e kaluar në rrjetet sociale, 310 e personave të anketuar u shprehën në këtë mënyrë:

(Figura 1)



Në pajtueshmëri me të dhënat nga ekzaminimi i anketimit, të gjithë të anketuarit mesatarisht kalojnë rreth **311,6 minuta në rrjetet sociale ose më shumë se pesë orë në ditë**.

Për krahasim, në nivel global në vitin **2021**, 55% e popullatës botërore përdor rrjete sociale. Njeriu mesatar kalon mesatarisht 2 orë dhe 32 minuta në rrjetet sociale. Tinejxherët kalojnë mesatarisht 3 orë e 1 minutë, dhe disa tinejxherë kalojnë edhe nga 9 orë në rrjetet sociale.¹⁵

Në nivel global është shënuar trend për zmadhimin e kohës së kaluar në rrjetet sociale nga ana e njeriut mesatar. Domethënë, në vitin **2012** koha mesatare e kaluar në rrjetet sociale ka qenë 90 minuta respektivisht një orë e gjysmë, në vitin **2016** koha mesatare e kaluar është 128 minuta në ditë, respektivisht 2 orë e 8 minuta, dhe në vitin **2019** koha e kaluar në rrjetet sociale është e zmadhuar për 145 minuta në ditë, respektivisht 2 orë e 25 minuta.¹⁶


Rrjetet sociale të përdorura më shpesh

Në paraqitjen e mëtejshme grafike janë paraqitur cilat nga rrjetet sociale i përdorin më shumë nxënësit e arsimit të mesëm.

¹⁵ https://famemass.com/time-spent-on-social-media/#What_Is_The_Average_Time_Spent_On_Social_Media_In_2021

¹⁶ <https://www.statista.com/statistics/433871/daily-social-media-usage-worldwide/>

(Figura 2)



Të rinjtë më shpesh e përdorin rrjetin social Instagram, ndërsa përdorimi i Facebook nga ana e të rinjve ka një trend të rënies. Të rinjtë përdorues të Facebook u zvogëluar për 13% në vitin 2019 dhe parashikohet rënie prej 45 % në 2 vitet e ardhshme.¹⁷

Përfaqësimi i keqtrajtimit në internet

Në lidhje me pyetjen a kanë qenë target i ndonjë lloj keqtrajtimit në internet nga gjithsej 317 i të anketuarëve, 247 theksuan se kanë qenë qëllim i keqtrajtimit në internet, ose 78% e personave që morën pjesë në këtë anketë. Ky numër është në mënyrë alarmante i lartë, respektivisht dyfish më të madh se rekordi botëror prej 34%.


¹⁷ <https://www.theverge.com/22743744/facebook-teen-usage-decline-frances-haugen-leaks>

(Figura 3)



Keqtrajtimi në internet është e përfaqësuar në të tre qytet si në Tetovë me 73%, në Shtip me 77 % dhe në Manastir me 83% nga numri i përgjithshëm i personave të anketuar.


(Figura 4)



Poshtërim, ofendime dhe turpërim në rrjetet sociale

Pyetjes “A keni qenë pjesë e poshtërimit, ofendimeve ose turpërimit në rrjetet sociale?” nga gjithsej 317 persona të anketuar, 40 persona të anketuar u përgjigjën pozitivisht, dhe ndërsa 246 u përgjigjën negativisht, dhe 31 persona të anketuar u përgjigjën se nuk e dinë.

(Figura 5)




Nga 40 persona që u përgjigjën në mënyrë pohuese se kanë qenë pjesë e përcmimit, ofendimit dhe turpërimit në rrjetet sociale **25 janë persona femra, dhe 15 meshkuj**. Nga gjithsej 40 persona, 31 persona u shprehën si heteroseksualë, një person u shpreh si biseksual, dhe 8 refuzuan t’i përgjigjen pyetjes për orientimin e tyre seksual.

Mesazhe ofenduese ose kërcënuese

Në lidhje me pyetjen nëse të anketuarit kanë fituar mesazhe ofenduese dhe kërcënuese në mesazhe SMS ose në Chat, 70 persona u përgjigjën me pohim, 226 u përgjigjën në mënyrë negative dhe 21 persona nuk e dinë.

(Figura 6)



Nga 70 persona që kanë fituar mesazhe të tilla ofenduese dhe kërcënuese , **46 janë të gjinisë femërore, dhe 24 janë të gjinisë mashkullore.** Nga gjithsej 70 persona, 53 persona janë shprehur si heteroseksualë, një person është shprehur si biseksual, dhe 14 kanë refuzuar t'i përgjigjen pyetjes për orientimin e tyre seksual. Nga gjithsej 23 persona që janë shprehur se janë persona me aftësi të kufizuara 7 kanë fituar mesazhe ofenduese dhe kërcënuese.

Thirrje nga numra të panjohur

Në lidhje me pyetjen nëse personat e anketuar kanë fituar thirrje nga numra të panjohur deri **227 ose 72% u përgjigjën më mënyrë pohuese,** ndërsa 71 ose 22% u përgjigjën në mënyrë negative, 19 personat e tjerë u përgjigjën me – nuk e di. Nga personat që u shprehën si homoseksualë dhe persona transgjnorë të gjithë kanë fituar thirrje nga numra të panjohur, ndërsa tek heteroseksualët 71% ose 175 kanë marrë thirrje nga numra të panjohur, tek biseksualët 8 nga 9 ose 89% kanë fituar thirrje nga numra të panjohur.

Shantazhe

Pyetjes “A keni qenë të shantazhuar me anë të sistemit kompjuterik 5% ose 15 nga numri i përgjithshëm i personave të anketuar kanë dhënë përgjigje pozitive, nga të cilët 6 persona janë persona me aftësi të kufizuara.

Kërcënime

Pyetjes “A keni qenë të kërcënuar me anë të sistemit kompjuterik” - 26 persona dhe 8% e numrit të përgjithshëm të personave të anketuar u përgjigjën në mënyrë pozitive, nga të cilët 4 ose 100% e homoseksualëve u shprehën me pohim, dhe 22% ose 2 e biseksualëve. Katër

persona ose 17% e personave me aftësi të kufizuara pohuan se kanë fituar kërcënime me anë të sistemit kompjuterik.

Vjedhje të identitetit personal

Në lidhje me pyetjen “A ju është vjedhur identiteti në rrjetet sociale”? 41 ose 13% u përgjigjën me pohim. Tek personat e gjinisë femër 31 pohuan se u është vjedhur identiteti përkrah 10 meshkujve, nga të cilët 28 persona me orientim heteroseksual, dhe 12 refuzuan të përgjigjen.

Shpërndarje të materialeve të filmuara

Pyetjes “A është shpërndarë fotografi e juaja në rrjetet sociale me qëllim që të jeni të përçmuar”? 35 të anketuar ose 11% u përgjigjën me pohim, nga të cilët **28 ishin femra përballë shtatë meshkujve.**

Pyetjes “A është shpërndarë video e juaja pa pëlqimin tuaj me qëllim që të jeni të përçmuar”?, 12 persona ose 4% u përgjigjën me pohim nga të cilët 6 meshkuj dhe 6 femra. Nga të cilët 50% ose 2 nga numri i përgjithshëm i homoseksualëve u përgjigjën me pohim dhe 67% e aseksualëve u përgjigjën me pohim.

Pyetjes “A është shpërndarë incizim audio i juaj pa pëlqimin tuaj me qëllim që të jeni të përçmuar”?, 5 persona ose 2 % u përgjigjën me pohim, nga të cilët 2 meshkuj dhe 3 femra. Prej tyre dy ishin heteroseksualë, dhe 3 nxënës u shprehën si aseksualë.

Shpërndarja e materialeve të filmuara me karakter intim

Pyetjes “A janë shpërndarë fotografi me konotacion seksual pa pëlqimin tuaj? - 11 nxënës ose 3% e të anketuarve u përgjigjën me pohim, nga të cilët gjashtë vajza dhe pesë djem. Në lidhje me orientimin seksual 6 prej tyre u shprehën si heteroseksualë, 2 homoseksualë dhe të tjerët refuzuan të japin përgjigje.

Pasoja nga keqtrajtimi në internet

Efekte emocionale

Nga 247 e të anketuarve që u shprehën se kanë qenë target i keqtrajtimit në internet, 76 e të anketuarve ose 31% janë ndjerë të shqetësuar, 13 të anketuar ose 5% janë ndjerë të turpëruar, 16 të anketuar ose 6% janë ndjerë të pafuqishëm, 12 të anketuar ose 5% nuk kanë dëshiruar të shoqërohen me asnjë, 130 ose 53% u përgjigjën se nuk i kanë ndjerë këto pasoja konkrete emocionale.

Efekte mbi shëndetin mendor

Nga 247 e të anketuarve që u shprehën se kanë qenë target i keqtrajtimit në internet, 19 e të anketuarve ose 8% janë ndjerë depresivë, 18 të anketuar ose 7% janë ndjerë në ankth, 17 të anketuar ose 7% janë ndjerë të trishtuar, 40 të anketuar ose 16% kanë qenë të hidhëruar, 32 ose 13% u ra vetëbesimi, një i anketuar dëshironte që të vetë-lëndohej, **11 ose 4% kanë menduar për vetëvrasje**. 109 e të anketuarve ose 44 % u përgjigjën se nuk i kanë ndjerë këto pasoja konkrete mbi shëndetin mendor.

Efekte mbi shëndetin fizik

Nga 247 e të anketuarve që u shprehën se kanë qenë target i keqtrajtimit në internet, 44 e të anketuarve ose 17% kanë pasur pagjumësi, 13 e të anketuarve ose 5% nuk kanë mundur të hanë, 20 e të anketuarve ose 8% kanë pasur dhimbje në stomak, 171 e të anketuarve ose 69% u përgjigjën se nuk i kanë ndjerë këto pasoja konkrete mbi shëndetin fizik.

Njohja dhe identifikimi me rolin e agresorit ose dhunuesit

Nga numri i përgjithshëm i 317 të anketuarve, 44 ose 14% për qind vetveten e identifikojnë si agresorë ose dhunuese, ndërsa 273 ose 86% shprehen se nuk kanë qenë agresorë ose agresor në hapësirën e internetit.

Midis personave që kryejnë keqtrajtim në internet dhe dhunë ka pasur 20 vajza dhe 24 djem.

Tek të anketuarit që identifikohen si agresorë dhe dhunues 30 janë heteroseksual, 2 homoseksualë, 2 aseksualë dhe 10 refuzojnë që të përgjigjen / nuk e dinë.

Tek të anketuarit që janë shprehur si persona me aftësi të kufizuara deri 11 nga numri i përgjithshëm prej 23 ose 48 % u shprehën si agresorë respektivisht dhunues në hapësirën e internetit.

Pyetjes “A njihni dikë nga shokët tuaj nxënës që ka qenë viktimë e keqtrajtimit në internet? - 144 ose 45% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve u shprehën me pohim, ndërsa 173 ose 55% u shprehën në mënyrë negative.

KONKLUZIONE

1. Nuk ekziston definicion për termin keqtrajtim në internet në nivel kombëtar.
2. Fëmijët në moshën nga 15 deri 18 vjeç përdorin mesatarisht nga 5 orë në ditë në rrjetet sociale.
3. Nga numri i përgjithshëm i personave të anketuar 78% u shprehën se kanë qenë viktimë e keqtrajtimit në internet.
4. Janë përfaqësuar më shumë forma të keqtrajtimit në internet, si dërgim i mesazheve ofenduese dhe përçmuese në rrjetet sociale, mesazhet SMS dhe Chat, thirrjet nga numra të panjohur, shantazhe, vjedhje të identitetit, shpërndarje të fotografive me konotacion seksual.
5. Edhe pse nuk është detektuar targetimi gjinor, duket se femrat dhe personat me orientim të ndryshëm seksual dhe identitet gjinor janë më të prekur nga keqtrajtimi në internet.
6. Është detektuar tema e ndaluar (temë-tabu) ndërmjet fëmijëve me fe myslimane në lidhje me shprehjen e gjinisë dhe orientimit seksual.
7. Pjesë e madhe e fëmijëve që kanë qenë viktimë të internetit kanë ndjerë një lloj efekti mbi shëndetin emocional, fizik ose mendor dhe deri 11 persona u shprehën se mendojnë për vetëvrasje si pasojë e keqtrajtimit në internet.
8. Më shumë se gjysma e personave me aftësi të kufizuara identifikohen si agresorë .

REKOMANDIME

1. Të definohet rëndësia e keqtrajtimit në internet në nivel kombëtar.
2. Të zbatohen trajnime nga institucionet kompetente arsimore me qëllim zvogëlimin e kohës së kaluar në rrjetet sociale nga ana e të rinjve deri në 18 vjeç.
3. Shteti të themelojë mekanizma kundër stereotipave gjinorë dhe nxitjen e barazisë gjinore dhe nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme shkollore dhe jashtëshkollore midis të rinjve.
4. Në programin e Arsimit seksual gjithëpërfshirës t'i përkushtohet vëmendje e veçantë për mësimin e identiteteve të ndryshëm seksuale dhe gjinore për shkak të lokalizimit të temës së ndaluar (tabu) ndërmjet të anketuarve, veçanërisht tek fëmijët që e kanë prejardhjen nga familjet myslimane.
5. Të krijohet mekanizëm për parandalimin e gjuhës së urrejtjes, diskriminimit dhe dhunës në të gjitha format e saj, nëpërmjet programeve të ndryshme sistemike për ndërgjegjësimin e prindërve, mësueseve dhe të gjitha grupet e interesit të sistemit të arsimit.
6. Të themelohet program për përfshirjen aktive të personave me aftësi të kufizuara në një numër më të madh aktiviteteve dhe inkluzionin dhe socializimin e tyre, si edhe sensibilizimin e nxënësve për pranimin e dallimeve.
7. Të themelohen mekanizma për zbulimin e hershëm të simptomave nga efektet negative të shëndetit të çrregulluar mendor dhe shpirtëror që i kanë ndjerë viktimat e internetit.
8. Themelimi i sistemit të alarmit dhe linjave SOS për raportimin dhe për mbështetjen urgjente psikologjike që do të bazohen mbi mirëbesimin ndërmjet nxënësit dhe personit të autorizuar nga shkolla me qëllim përforcimin e viktimave të internetit.
9. Trajnim dhe punëtori për të drejtat dhe përgjegjësitë digjitale si edhe për pasojat nga keqtrajtimi i internetit tek të rinjtë, si për fëmijët ashtu edhe për prindërit.

PJESA E TRETË

Gjuha e urrejtjes ndërmjet grupeve të tifozëve

Prania gjuhës së urrejtjes në eventet sportive është problem serioz që inicion dhunë dhe sjellje të pahijshme që mund të tejkalojë në huliganizëm.¹⁸ Problemi me gjuhën e urrejtjes në eventet sportive është gjithandej i pranishëm kudo në botë. Këshilli i Evropës në vitin 1985 e miratoi Konventën Evropiane për dhunë tek shikuesit.¹⁹ Ajo përcakton obligim pozitiv të shteteve – anëtare për parandalimin dhe luftën kundër dhunës dhe sjelljes së pahijshme së shikueseve në ndeshjet e futbollit. Njëkohësisht kërkohet ndërmarrje e ndryshimeve ligjore dhe kushtetuese në të cilat do të sigurohen formulimi dhe zbatimi i masave për parandalimin dhe kontrollin e dhunës dhe sjelljes së pahijshme të shikueseve.

Në kuadër të projektit “Aksion i përbashkët kundër gjuhës së urrejtjes” ishte parashikuar bashkëpunim me grupet e tifozëve të qyteteve: Manastir, Shtip dhe Tetovë. Për atë qëllim ishte parashikuar që të zbatohen tre grupe -fokusi me grupet e tifozëve të këtyre qyteteve²⁰, Paraprakisht ishte përcaktuar metodologjia mbi të cilën do të zbatohen grupet e fokusit.

Puna me këto grupe tifozësh ishte e menduar në drejtim që të qaset në mënyrë të hapur ndaj këtyre grupeve formale dhe joformale, të depërtojë në thelb, respektivisht burimi dhe motivet e urrejtjes për keto bërthama lokale të tifozëve, dhe të forcohet lufta kund gjuhës së urrejtjes në sport. Nga kjo punë me grupet e tifozëve është e pritur që të dalin koncepte për përforcimin e arsimit, masave sociale dhe kulturore dhe strategjive për parandalimin e gjuhës së urrejtjes së ndeshjeve sportive, organizim të fushatave për publicitet në çdo vend pjesëmarrës, me pjesëmarrje të lojtarëve popullorë për nxitjen e atmosferës së tolerancës.

Ekipi i projektit disa muaj bënte përgatitje dhe mundime që të krijojë kontakte me përfaqësuesit e grupeve qëllimore të tifozëve. Ishin realizuar biseda telefonike, ishin bërë mundime për takime të drejtpërdrejta, por nga ana e personave të kontaktit të grupeve të tifozëve “Çkembari” nga Manastiri dhe “Falanga” nga Shtip ishte njoftuar se nuk kanë mirëbesim tek askush dhe se nuk dëshirojnë që të bashkëpunojnë me asnjë. Bashkëpunimi ishte realizuar vetëm me grupin e tifozëve “Vojvoda” nga Tetova.

¹⁸ Huliganizmi në përgjithësi sillet në mënyrë destruktive, agresive dhe kriminale, dhe që lidhet me tifozët e sportit

¹⁹ <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treatynum=120>

²⁰ Çkembarët nga Manastiri, Vojvodat na Tetova dhe Falanga nga Shtip.

GJETJE NGA ZBATIMI I GRUPIT TË FOKUSIT _____

1. Profili i grupit të fokusit

Në grupin e fokusit morën pjesë 7 pjesëmarrës të moshës së ndryshme, të gjithë të gjinisë mashkull, më i moshuari është në moshën 47 vjeçare, më i ri në moshën 23 vjeçare, të gjithë nga grupi i tifozëve “Vojvoda”. Në lidhje me përkatësinë etnike dhe nacionale, të gjithë pjesëmarrësit ishin Maqedonas që flasin maqedonisht.

2. Gjetje kyçe

Të gjithë pjesëmarrësit ndjejnë lidhshmëri të thellë me grupin e tifozëve, me ndjenjë të fuqishme të bashkësisë dhe përkatësisë për atë bashkësi. Ndjehen të fuqishëm dhe të sigurt për arsyen se janë pjesë e atij grupi. Disa prej tre nuk kanë humbur asnjë ndeshje të Klubit të futbollit “Teteks”. Të gjithë u bënë tifozë nga vitet e hershme, të frymëzuar nga miqtë më të vjetër, nga vëllezërit dhe fqinjët. Për momentin më aktivë janë anëtarët më të rinj, ata mësojnë nga më të moshuarit, dhe duan të jenë me ta. Janë të hapur për anëtarë të rinj dhe për zgjerimin e grupit.

Kanë dy këngë tifozerie që i kanë të preferuarat, dhe fillimisht janë kënduar nga “Vojvodat” E para është “Izlezi momçe pravo na terasa i pozdravi ja Gocevata rasa” (Dil or djalosh direkt në ballkon dhe përshëndete racën e Goces) dhe e dyta është: “Nash klub, nash grad, nam ni pripagja” (Klubi ynë, qyteti ynë, na përket neve).

Konsiderojnë se si tifozë janë të nxirë dhe paraqesin gjithçka që nuk është e bukur, madje janë edhe target i përndjekjes nga organet. Anën e ndriçuar (pozitive) e shohin në shoqërimin e përbashkët, në mbledhjen e donacioneve, në bërjen e aksioneve humanitare kur ka nevojë, por megjithatë konsiderojnë se vlerat e tyre nuk janë të dukshme për publikun.

Momenti më i bukur për ta është fitorja mbi “Shkëndinë” në finalen e Kupës në vitin 2015. Theksojnë se në ndeshje ka rivalitet tifozerie, por ata shpesh herë janë të përçmuar në bazë nacionale dhe fetare me djegien e flamujve, me parulla, me thirrjen Karpallak²¹, Vejce²², Makedonsko devojçe ku*va golema (Vajza Maqedonase ku*vë e madhe) etj., dhe kanë ndjenjën se tifozët rivalë, Ballistët nuk e respektojnë shtetin dhe e ofendojnë. Tregojnë për ndarje midis Shqiptarëve dhe Maqedonasve në Tetovë.

Nuk kanë besim mbi policinë, konsiderojnë se janë të diskriminuar dhe se policia e mbron popullin shqiptar përballë popullit maqedonas. Për shkak të mosbesimit ndaj policisë, nuk i

²¹ Masakra në Karpallak — masakra më e madhe mbi ushtarët në konfliktin ushtarak të vitit 2001.

²² Masakra në Vejce — masakra më e përgjakshme dhe më brutale në historinë më të re të Maqedonisë në vitin 2001.

raportojnë rastet, por edhe ato raste që janë të raportuara nuk ka Rezultat. Konsiderojnë se policia nxit me qëllim tensione ndëretnike, dhe i ndryshon rutat e lëvizjes së grupit të tifozëve “Vojvoda” me qëllim që t’i çojë në pjesën shqiptare dhe pa u bërë llogari për sigurinë. Në ndeshjet KF “Teteks” – KF “Shkëndija”, “Vojvodat” si grup më i vogël gjithmonë dalin të fundit nga stadiumi, dhe të parët lëshohet për dalje tifozët shqiptarë. Konsiderojnë se ajo është diskriminim dhe se në asnjë vend në botë nuk është praktikë që grupi më i vogël i tifozëve të dalë i fundit.

Tregojnë se ndodhin edhe vepra nga urrejtja, si për shembull gjuajtja me gurrë e shtëpive të popullatës maqedonase nga ana e Ballistëve. Thonë se ajo ndodh para syve të policisë, por për fat të keq për këto incidente aspak nuk udhëhiqen procedura, dhe për ata që ka procedura, nuk ka vendim gjyqësor.

Janë të revoltuar nga fakti që edhe pse Tetova ka tre stadione të qytetit KF “Teteks” nuk luan në asnjë prej tyre. Të tre stadiumet janë në qeverisje të Komunës së Tetovës dhe i janë dhënë klubeve shqiptare dhe u janë dhënë pushtetarëve vendas. Theksojnë se ndjehen të lënduar për faktin se KF “Teteks” nuk luan në stadiumin e Qytetit, që ka qenë i ndërtuar nga prindërit e tyre me kontributin e tyre si punëtorë në Fabrikën e tekstilit “Teteks”. Tregojnë se për këtë problem ata kanë vendosur që të mobilizohen dhe të gërenë peticion.

Komente:

- “Unë jam nga më të rinjtë, më shumë se 5-6 vjet jam tifoz, ne mësojmë nga më të mëdhenjtë dhe shohim prej tyre. Ata janë ashtu siç ne duam që të jemi dhe që të mirëmbahet emri Vojvoda ashtu si e meriton. Ata e kanë mirëmbajtur ne duam ta mirëmbajmë akoma më shumë dhe akoma më mirë”.
- “Ajo është që në moshë të vogël. Askush nuk mund të të detyrojë. Ose je se nuk je. Ka fjalë të urtë të vjetër, “Vojvodë” nuk bëhesh. “Vojvodë” lind.”
- “Kemi miq, shoqërim, bashkësi. Por mangësi ka shumë, je i nxirë, paraqet gjithçka që nuk është e bukur, kështu të karakterizojnë faktikisht.
- Po, edhe shtëpi bëmë, as fotografohemi dhe as promovohemi, bëjmë edhe aksion për dhurimin e gjakut. Dhe në plan kemi të bëjmë edhe një organizatë humanitare dhe të punojmë, ai është plani.
- Kishte përçmime dhe ajo përçmime të rënda. Vejce, Karpallak, Ballistë me parulla me zastava me koreografi. Ne reagojmë në mënyrë të furishme, por gjithçka varet nga policia. Provokimet janë më shpesh me bazë nacionale dhe fetare.

- Digjen flamuj, ndonjë fëmijë rrugës do ta rrahin. Do të raportohet ajo situatë, po do të mbulohet disi. Ajo ka qënë non-stop, ata janë arinj të mbrojtur.
- Në festën e përvjetorit të 30-të, kur kthehesha për në shtëpi në semafor më ndaluan dhe më sulmuan. (tregon me dorë në drejtim të hundës).
- Dhe paska diskriminim në çdo ndeshje. Vojvodat në fund të ndeshjes gjithmonë kanë qenë të ndaluar që fillimisht të dalin Ballistat, dhe pastaj Vojvodat. Kudo në botë fillimisht lihet të dalë grupi më i vogël. Ne nëse kemi qenë 1000, dhe ata 15000 nuk mundet që fillimisht ata t'i lëshojnë. Dhe na gjuajnë me gurë të bërë gati, dhe mund të na pastrojnë për 15 minuta. Dhe kjo është në çdo derbi Shkëndija – Teteks. Pastaj ata dalin në të gjithë qytetin, dhe ne presim një orë, një orë e gjysmë. Pritet të raportohet se ikën në shtëpi.
- Nuk raportova sepse doktori lart në spital është udhëheqësi i Ballistëve (qesh). Të dy nga policia ishin po ashtu njerëz të tyre. Kemi raportuar incidente më të vogla por nuk mund të zbulohen keqbërësit. Është gjithmonë në sirtar.
- Nga policia ne jemi ana më e ngjeshur. Mbi ne mund të godasin. Sepse në anën tjetër nuk mundën prandaj.
- Ne jemi realisht qytetarë të rendit të dytë, ashtu ndjehemi. Dhe kështu është edhe në Shkup. Jo vetëm si tifozë, por edhe si Maqedonas. Kudo, edhe në spital.
- Unë kam raportuar kërcënime nga ana e Ballistëve në Facebook. Ato kërcënime ishin për një ose dy muaj. U konsultova me një inspektor se çfarë të bëj. Dhe ata më shkruanin mesazhe, po të shoh tani po kalon tek kopshti, do të vijë dita jote, do të vrasim... dhe kështu çdo ditë. Raportova në krim-teknika, me telefon. I fotografoja mesazhet dhe më thanë, mbase edhe unë i kam provokuar, u kam kthyer mesazhe dhe pastaj i kam fshirë. Unë nuk u kisha kthyer mesazheve. Që të dy ishin policë Shqiptarë dhe më thanë i ke provokuar. Më thanë do të shohim se çfarë do të bëjmë. Që atëherë nuk më shkruanin, por nuk fitova asnjë përgjigje se kush janë, çfarë janë dhe nëse i kanë kapur.
- Momentalisht as Teteks dhe as Ljuboten nuk kanë stadione, nga tre stadiumet. Nuk e di se si humbën dokumentet. Tani Teteks luan si mysafir në Bogovinjë, nëpër fshatra. E kanë të ndaluar që të luajnë në Tetovë. Për mua fëmijëria më ka kaluar atje, dhe prindërit tanë e kanë ndërtuar. Ajo është fatkeqësi, politika ka ndërhyrë shumë.

KONKLUSIONE

1. Mbyllja e përgjithshme e grupeve të tifozëve për bashkëpunim me të gjitha grupet e jashtme të institucioneve dhe individëve duke përfshirë edhe sektorin civil.
2. Ekziston përfshirje më e madhe e tifozëve më të rinj në aktivitetet e tifozerisë.
3. Si rezultat i ndarjes shoqërore në bazë etnike, tek tifozët ekziston ndjenjë e padurimit, mostolerancës dhe përçarjes në bazë të përkatësisë etnike dhe besimit religjioz.
4. Ekziston mosbesim, komunikim i pamjaftueshëm dhe bashkëpunim ndërmjet tifozëve dhe policisë, prej këtu tek tifozët shfaqet perceptim negativ për punën e policisë.
5. Tek tifozët ekziston potencial kolektiv dhe dëshirë më e madhe për organizimin e aksioneve vullnetare dhe humanitare.

REKOMANDIME

1. Përforsim të masave të arsimit, masave sociale, kulturore dhe strategjive për parandalimin e gjuhës së urrejtjes dhe veprave nga urrejtja ndërmjet grupeve të tifozëve.
2. Qasje holistike në nivel institucional, gjithçka me qëllim që të integrohen planet dhe strategjitë për luftën kundër gjuhës së urrejtjes dhe veprave penale të motivuara nga urrejtja në eventet sportive.
3. Bashkëpunim efikas dhe efektiv ndërmjet palëve të prekura (grupeve të tifozëve, klubeve sportive, qeverisjes lokale, policisë etj.) gjithçka me qëllim që të zvogëlohet gjuha e urrejtjes dhe mostolerancës, duke përfshirë njoftime dhe evidentim të incidenteve.
4. Ndërgjegjësim nëpërmjet zbatimit të fushatave nëpërmjet të cilave do të ndikohet mbi ndryshimin e mentalitetit, tregimit të publikut të përgjithshëm për rreziqet nga gjuha e urrejtjes, themelim të mekanizmit për regjistrimin dhe njoftimin e rasteve të gjuhës së urrejtjes në evente t sportive.
5. Luftë kundër mosndëshkimit të gjuhës së urrejtjes në ndeshjet sportive përmes raportimit të vazhdueshëm të rasteve.
6. Bashkimi dhe niveli i lartë i organizimit të tifozëve që të shfrytëzohet si shembull pozitiv për zbatimin e aksioneve për rgjegjëse shoqërore.

RAPORT VJETOR PËR GJENDJEN ME
**GJUHËN E
URREJTJES**

NË NIVEL LOKAL NË QYTETET, TETOVË,
MANASTIR DHE SH TIP PËR VITIN 2021



FOUNDATION | ФОНДАЦИЈА
OPEN | ОТВОРЕНО
SOCIETY | ОПШТЕСТВО
MACEDONIA | МАКЕДОНИЈА